

**Seminari për Energjinë e Ripërtëritshme në Ballkan
(Oda Ekonomike e Kosovës & Belaj Technology)**

Zyra e Rregullatorit të Energjisë

**Korniza Ligjore & Përkrahja Rregullatore për zhvillimin
e burimeve të ripërtëritshme të energjisë**

Azem Kastrati

Kryesues i DMK të ZRRE-së

Prishtinë

01 Shkurt 2006



ERO

www.ero-ks.org

Burimet e Ripërtërithshme të Energjisë (BRE) Korniza Ligjore

‘burimet e ripërtërithshme të energjisë’
nënkuptojnë burimet e ripërtërithshme pa
fosile të energjisë (era, energjia solare,
gjeotermale, valore, ujore, biologjike, gazet
tokësore, uzinat për përpunimin e gazeve
dhe biogazet)

p
r
e
j

Nenit 3 Ligji mbi Energjinë - Terminologjitë, Direktivat e KE: 2003/54/EC dhe
2001/77/EC - Terminologjitë



ERO

Manadati Legal i Institucioneve për BRE (i-1)

→ **Politika**

MEM

→ **Ligji**

→ **Monitorimi**

Mandati:

- përcakton caqet indikative për shfrytëzimin e energjisë së gjeneruar nga BRE;
- përgatitë programet zbatuese për promovimin e BRE;
- përgatitë propozimet për stimulimin e shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- monitoron shfrytëzimin e BRE dhe realizimin e caqeve indikative për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme;



ERO

Mandati Legal i Institucioneve për BRE (i-2)

- **Politika**
- **Ligji**
- **Monitorimi**

MEM

Mandati:

- përgatitë aktet nënligjore, pas konsultimit me **Zyrën e Rregullatorit për Energji** për promovimin e shfrytëzimit efikas të energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- nxitë operimin e organizatave joqeveritare që veprojnë në interesin e përgjithshëm në sektorin e energjisë; dhe
- promovon rritjen e kontributit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë për prodhimin e energjisë në tregun e brendshëm dhe tregjet rajonale të energjisë elektrike në përputhje me objektivat e synuara të përcaktuara nga **MEM-i**.

Mandati Ligjor i Institucioneve mbi BRE-të (ii-1)

- **Licencim**
- **Promovim dhe stimulim**
- **Monitorim**

ZRRE

Mandati:

- ▶ Lëshon çertifikata të origjinës për energjinë e gjeneruar nga BRE-të
- ▶ Siguron që taksat e bartjes dhe distribuimit nuk shkaktojnë diskriminim ndaj energjisë elektrike të prodhuar prej burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- ▶ Siguron që metodologjia e tarifave, sistemi tarifor dhe vendosja e tarifave do të nxitë iniciativat për zhvillimin e BRE-së;
- ▶ Paraqet sistemin tarifor që siguron stimulime për promovimin e shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Mandati Ligjor i Institucioneve mbi BRE-të (ii-2)

- **Licencim**
- **Promovim dhe stimulim**
- **Monitorim**

ZRRE

Mandati:

- ▶ gjatë caktimit të tarifave, ZRRE-ja mund të sigurojë **burime të financimi** përmes tarifave, të implementuara nga palët e treta të zgjedhura me ofertim konkurrues, duke operuar sipas procedurave transparente.
- ▶ monitoron që të licencuarit (TSO, DSO, Furnizuesi Publik dhe furnizuesit tjerë) janë në përputhje me detyrimet (që rrjedhin prej Ligjeve) ndaj energjisë elektrike të gjeneruar prej BRE-ve.
- ▶ merr pjesë në konsultime me MEM në përgatitjen e legjislacionin dytësor, në lidhje me burimet e ripërtëritshme të energjisë.



ERO

Mandati Ligjor i Institucioneve mbi BRE-të(iii-1)

Furnizuesi Publik, Furnizuesit tjerë, TSO, DSO

- ▶ Furnizuesit publik u japin përparësi në blerje të energjisë elektrike për të cilën është marrë çertifikata e origjinës, me kusht që kostoja e energjisë të tillë nuk shpie çmimin e energjisë elektrike në Kosovë në një nivel të lartë jo stabil. Nga furnizuesi publik kërkohet që ta blejë, me **çmim të rregulluar (“kompenzim në tarifë”)**, gjithë sasinë e energjisë elektrike të prodhuar për të cilën ekziston çertifikata e origjinës. ZRRE-ja, mund t’ia kompenzojë shpenzimet furnizuesit publik, përmes një **tarifë të veçantë** për shërbimet e operatorit të sistemit të bartjes (TSO)
- ▶ Në rastin kur sistemi **tregëtues i çertifikatave të origjinës** është i vendosur, atëher MEM/ERO mund të caktojë gjoha te secili furnizues përfshirë edhe furnizuesin publik për mosarritjen e **caqeve indikative** të kërkuara.

Mandati Ligjor i Institucioneve mbi BRE-të(iii-2)

Furnizuesi Publik, Furnizuesit tjerë, TSO, DSO

- ▶ TSO, kur shpërndajnë gjenerimin duhet t'i japin **përparësi** gjenerimit që bëhet me burime të ripërtëritshme të energjisë.
- ▶ Operatorët e Sistemit përcaktojnë dhe publikojnë **rregullat standarde** mbi atë se **kush i bartë shpenzimet** e adaptimeve teknike, siq janë lidhjet dhe përforcimet e sistemeve, të domosdoshme për integrimin e prodhuesve të energjisë eklektrike të prodhuar nga BRE-të në sistemin e ndërlidhur të rrjetës. (rregullat e aprovuara nga ZRRE-ja)

Legjislacioni i BE-së dhe Traktati i ECSEE mbi BRE(i)

- Direktiva e BE-së 2001/77/EC mbi promovimin e elektricitetit të prodhuar prej Burimeve të ripërtëritshëm të energjisë:
 - Energjia elektrike e prodhuar prej BRE-ve është një **prioritet** i lartë i Komunitetit dhe një synim domethënës global për anëtarët e e BE-së, për të pasur **12% të konsumit të përgjithshëm vendor të energjisë deri në 2010**
 - Anëtarët e BE-së do të promovojnë përdorimin e BRE-ve në një mënyrë efektive, të thjeshtë dhe njëkohësisht sa më efikase që të jetë e mundur, veçanërisht për sa i përket kostove. Ato do të përfshijnë periudha të mjaftueshme kalimtare prej të paktën 7 vjet, do të ruajnë fshehtësinë e investitorëve dhe do të shmangin kostot e mbetura.
 - Zvogëlimi i pengesave rregullatore dhe jo-rregullatore ndaj rritjes së prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve të ripërtëritshme të energjisë.
 - Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që TSO-të dhe DSO-të në territorin e tyre, do të garantojnë transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike të prodhuar prej burimeve të ripërtëritshme të energjisë, dhe gjatë instalimeve të shpërndarjes së gjeneratorëve, TSO-të do t'i japin përparësi instalimeve gjeneruese që përdorin BRE, për aq sa kjo gjë është e lejuar nga sistemi kombëtar I elektricitetit.



ERO

www.ero-ks.org

Legjislacioni i BE-së dhe Traktati i ECSEE mbi BRE (ii)

- **Direktiva e BE-së 2003/30/EC mbi promovimin e përdorimit të bio-karburantëve ose karburantëve të tjerë të ripërtëritshëm për transport.**

- **Traktati ECSEE :**
 - Përvetësim i burimeve të ripërtëritshëm

 - Çdo palë kontraktuese brenda një viti pas hyrjes në fuqi të traktatit, do t'i sigurojë Komisionit Evropian një **plan** (MEM) për të zbatuar Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC të Komunitetit Evropian mbi burimet e ripërtëritshme. Komisioni Evropian e miraton me shumicë votash.

Mbështetja e Rregullatorit për Zhvillimet e BRE (i)

Sfida është që të identifikohet një çmim që inkurajon prodhuesit e ripërtëritshëm, por nuk përfaqëson një çmim (premium) shumë të lartë mbi koston e prodhuesve konvencionalë

Në vendet e BE-së përdoren lloje të ndryshëm të mbështetjes së Drejtpërdrejtë financiare, si:

- Tarifa kompensuese (Feed-in tariff)
- Tender konkurrues
- Kredi prodhimi
- Detyrim i ripërtëritjes (caqe indikative) me kredi të tregtueshme ripërtëritëse (çertifikatat)
- Stimulime në taksa

Duhet të theksohet se tarifatat kompensuese në shume shtete (Gjermani, Danimarkë, Spanjë Greqi, ...) janë miratuar gjerësisht si një mjet madhor për mbështetjen e energjisë së ripërtëritshme (siç është paraqitur në tabelën vijuese).



Table gives a broad summary of the type of support by technology currently in place in various European countries.

| | Generic | Wind | Hydro | Biomass | PV | Geothermal | Solar Thermal |
|----------------|---|--------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Austria | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff |
| Belgium | Feed-in tariff Quota system | | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff |
| Denmark | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff |
| Finland | Tax incentives | Tax incentives | Tax incentives | Tax incentives | Tax incentives | Tax incentives | Tax incentives |
| France | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff Investment Support | Feed-in tariff | Feed-in tariff |
| Germany | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff |
| Greece | Feed-in tariff Investment Support | Feed-in tariff Investment Support | Feed-in tariff Investment Support | Feed-in tariff Investment Support | Feed-in tariff Investment Support | Feed-in tariff Investment Support | Feed-in tariff Investment Support |
| Ireland | Investment support Tax incentives | Tax incentives Bidding Scheme | Tax incentives Bidding Scheme | Tax incentives Bidding Scheme | Tax incentives | DNA | Tax incentives |
| Italy | Quota System | Quota System | Quota System | Quota System | Quota System | Quota System | Quota System |
| Luxembourg | | | | | | | |
| Netherlands* | Tax incentives Feed-in tariff | Tax incentives Feed-in tariff | Tax support Feed-in tariff | Tax incentives Feed-in tariff | Tax incentives Feed-in tariff | Investment support Feed-in tariff | Tax incentives Feed-in tariff |
| Portugal | Investment support Feed-in tariff | Investment support Feed-in tariff | Investment support Feed-in tariff | Investment support Feed-in tariff | Investment support Feed-in tariff | DNA | Investment support Feed-in tariff |
| Spain | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff | Feed-in tariff |
| Sweden** | Quota System | Quota System | Quota System | Quota System | Quota System | Quota System | Quota System |
| United Kingdom | Quota system Climate Change Levy (CCL) | Quota system | None | Quota system Investment Support | Quota system Investment Support | DNA | Quota system |
| EU | | | | | | | |

Mbështetja e Rregullatorit ndaj Zhvillimeve të BRE (ii)

- Ligji mbi Energjinë Elektrike (Neni 10) kërkon që ZRRE-ja të lëshojë certifikata origjine për energjinë e gjeneruar nga BRE-të, dhe që furnizuesi publik është i detyruar të blejë këtë energji me çmim të rregulluar. Kjo kërkesë është ekuivalente e përdorimit të **“tarifës kompensuese”**, siç aplikohet në një sërë vendesh të BE-së. Sipas kësaj, energjia e gjeneruar prej burimeve të ripërtëritshme, blihet me një kosto (premium) ndaj çmimeve në **tregun konkurrues të shumicës**.
- Çmimi që do të paguhet për blerjen e energjisë elektrike të ripërtëritshme, mund të mbulohet përmes ngarkesave të Shfrytëzimit të Sistemit Transmetues, të aprovuar nga ZRRE-ja (Ligji mbi En. elektrike)
- Përvoja e vendeve të BE-së me tarifën kompensuese zakonisht ka qenë e suksesshme në promovimin e investimeve në gjeneratorët e energjisë së ripërtëritshme, por tenton të shkojë drejt investimeve **“të larta” dhe rritje të mëdha në koston për konsumatorët**.
- Tenderi Konkurrues; vendos një çmim tavan dhe kërkon nga gjeneratorët e energjisë së ripërtëritshme që të konkurrojnë për t’u kualifikuar për shitjet sipas çmimit tavan të vendosur. Konkurrenca nënkupton që premiumi do të ofrohet me çmim të poshtëm deri në nivelin ku është I mjaftueshëm për të mbuluar kostot shtesë të gjeneratorëve të energjisë së ripërtëritshme.



Konkludim (1)

Duke pasur parasysh kornizën ligjore të Kosovës, dhe në veçanti Ligjin mbi Energinë, Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, dhe Ligjin mbi Energjinë elektrike, duke pasur parasysh Direktivat e BE-së dhe Traktatin e ECSEE në lidhje me BRE-të, ZRRE-ja do të mbështesë zhvillimet e BRE-ve në kuadër të kompetencave që i ka me qëllim të implementimit të politikave të vendosura dhe aprovuara nga MEM, përmes:

- Monitorimit të të licencuarve (Furnizuesve Publikë, TSO dhe DSO) në detyrimet e tyre për blerjen e energjisë prej gjeneratorëve që përdorin BRE
- Vendosjen e kritereve për çertifikatat e origjines
- Lëshimin e çertifikatave të origjinës
- Vendosjen e nivelit të taksave të kompenzimit
- Aprovimit të tarifave dhe tarifave kompensuese për të mbuluar çmimin e paguar për blerjet prej gjeneratorëve të energjisë së ripërtëritshme

Konkludim (2)

- Uljes së pengesave rregullatore për të lejuar rritjen në prodhimin e energjisë prej BRE-ve
- Përgatitjes së tenderit konkurrues
- Pjesëmarrje në konsultime me MEM dhe mbështetës të tjerë, në përcaktimin e synimeve dhe politikave për zhvillimin e BRE-ve.

**Në emër të Zyres së Rregullatorit për
Energji (ZRRE-së) ju falenderoi për
bashkëpjesëmarrje në këtë prezentim**



ERO